



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.09.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit në datat 12.07.2018 dhe 19.07.2018.
2. Miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 3 -21 shtator 2018.
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Evropiane (Europol), për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr. 28/2014”.
4. Seancë dëgjimore me kandidatët për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka.

Të ftuar:

Besfort Lamallari - Zëvendësministër i Brendshëm

Shkelzen Rexhepi - përfaqësues i Europolit.

Andi Muratej - kandidat për anëtar i Komisionit të Pavarur

Artan Spahiu - kandidat

Gëzim Allaraj - kandidat

Illir Kadiu - kandidat

Irena Nino - kandidate

Saimir Shehri - kandidat

Saimir Vishaj- kandidat

Suzana Pasha (Hoti)- kandidate

Lindita Rusmali- kandidate

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja –Të nderuar kolegë,

Të nderuar përfaqësues të medieëve,

Më lejoni të them pak fjalë në këtë mbledhje të parë të këtij sesioni të ri parlamentar. Dua ta nis me një falënderim për Kuvendin e Shqipërisë, posaçërisht për Kryetarin e Kuvendit të Shqipërisë lidhur me kushtet e reja të punës të krijuara për të gjitha komisionet e përhershme të Kuvendit, në veçanti të Komisionit të Ligjeve me këtë infrastrukturë të re tashmë, me të cilën që sot do të nisim punën.

Dua të them pak fjalë edhe për sesionin e ri parlamentar që kemi përpara në lidhje me punën e komisionit tonë. Do të jetë një sesion i ngjeshur parlamentar dhe ky komision do të vazhdojë të luajë si deri sot funksionin e tij të përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë, funksionin legjislativ. Na presin shumë projektligje të rëndësishme përpara. Në objektivin e punës së këtij komisioni është përmbyllja e paketës së 27 ligjeve të dyta të paketës së dytë të reformës në drejtësi. Konkretisht në axhendën e punës së këtij komisioni do të jenë 6 projektligjet e fundit të kësaj pakete. Në punën e këtij komisioni për sa i përket funksionit legjislativ do të jetë edhe projektligji “Për disa ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, një nismë e 37 mijë zgjedhësve. Po ashtu siç e dini nga sesioni i kaluar ne kemi në axhendë edhe një projektligj shumë të rëndësishëm që e kemi adresuar në Komisionin e Venecias për të marrë një opinion miqësor në lidhje me projektligjin për nismën ligjvënëse të shtetasve në Republikën e Shqipërisë, si edhe një sërë projektligjesh të tjera që gjatë këtij sesioni parlamentar do të na vijjnë nga qeveria, deputetët, por edhe nga zgjedhësit.

Komisioni i Ligjeve do të vazhdojë të ushtrojë si deri sot edhe funksionin e tij kontrollues në lidhje me institucionet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj që janë në sferën e përgjegjësisë së këtij komisioni. Nuk do të mbetet jashtë punës së komisionit tonë në këtë sesion parlamentar edhe funksioni i tretë jo pak i rëndësishëm, që është funksioni zgjedhës, që ka Komisioni i Ligjeve për ato institucione dhe ato organe, të cilat janë në sferën e përgjegjësisë së Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Po ashtu, edhe nënkomisionet e ngritura që në fillimin e kësaj legjislature, si Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut, Nënkomisioni për Administratën Publike dhe

Nënkomisioni për Pushtetin Vendor do të vazhdojnë të ushtrjnë funksionet e tyre të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit, por edhe në detyrat dhe misionin e këtij komisioni.

Dua të falënderoj kolegët e mi deputetë, pa përjashtim, edhe kolegët e opozitës, që sot, në fakt në respekt të kësaj mbledhjeje të parë të këtij komisioni, pavarësisht axhendës së tyre politike, duhet të ishin të pranishëm, për punën e mirë që bëme në sesionin e kaluar. Në të dhënat narrative të Kuvendit të Shqipërisë lidhur me punën e komisioneve të përhershme të Kuvendit, për shkak të natyrës dhe gamës së gjerë të veprimtarisë që ka Komisioni i Ligjeve ne vazhdojmë të mbetemi ndër komisionet që kemi përballuar një ngarkesë jashtëzakonisht të madhe pune në raport me komisionet e tjera të Kuvendit. Shpresoj që edhe në këtë sesion parlamentar në bashkëpunim edhe me kolegët e opozitës, të cilët i ftoj të japin kontributin e tyre në mbarëvajtjen e procesit ligjvënës gjatë këtij sesioni, ne t'ia dalim mbanë për të realizuar ata objektiva që na kanë ngarkuar zgjedhësit, por edhe Kushtetuta dhe ligjet e vendit.

Faleminderit!

Pa humbur kohë vazhdojmë me rendin e ditës për këtë mbledhje të parë të komisionit. Kemi 4 çështje në rendin e ditës.

Pika e parë është miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit në datat 12 dhe 19 korrik 2018. Kolegët janë njohur me procesverbalet. Ka vërejtje? Nuk ka.

Miratohen.

Pika e dytë është miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 3-21 shtator 2018.

Pika e tretë është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (Europol), për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr. 28/2014”. Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi.

Pika e katër është seanca dëgjimore me kandidatët për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë". Komisioni ynë është komisioni përgjegjës. Është një detyrim që buron nga ligji “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë” në kuadrin e zbatimit të reformës në drejtësi, detyrim, i cili Komisioni i Ligjeve, për shkak edhe të rëndësisë që ka e ka vendosur si pikë të katërt në këtë rend dite për të ecur sa më shpejt të jetë e mundur, për ta përmbyllur dhe këtë detyrim që kemi në raport me reformën në drejtësi.

Vazhdojmë me kalendarin. Jeni dakord?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe unë i bashkohem urimit për punime të mbara. Kam një sugjerim lidhur me kalendarin. Ditën e mërkurë në 19 shtator është planifikuar fillimi i diskutimit të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për avokaturën e shtetit””. Po atë ditë me kërkesën e Kryetarit të Kuvendit bazuar në vendimin që ka marrë komisioni, ne presim Komisionin e Venecias për të pasur një ditë diskutimesh të karakterit teknik lidhur me projektligjin e depozituar për nismën me 10 mijë firma. Duke qenë se pothuajse të gjithë ne do të jemi të angazhuar në aktivitetet dhe në takimet me Komisionin e Venecias do të sugjeroja që diskutimi i projektligjit “Për avokaturën e shtetit” të shqyrtohet në një ditë tjetër nga datat e tjera të mbledhjeve dhe data 19 shtator të ishte e lirë për të qenë në dispozicion të diskutimeve që do të bëjmë me ekspertët e Komisionit të Venecias.

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Hysi!

Nëse do të gjejmë hapësirë në këtë kalendar, mund ta përfshijmë në një datë tjetër shqyrtimin në parim të projektligjit “Për avokaturën e shtetit”, por bashkohem me sugjerimin tuaj, që data 19 të jetë e lirë për shkak edhe të këtij angazhimi që kemi me ekspertët e Komisionit të Venecias.

Ka sugjerime të tjera për kalendarin? Nuk ka. Jeni dakord edhe me sugjerimin e koleges Hysi?

Miratohet.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (Europol), për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr. 28/2014”. Siç e thashë në fillim jemi komision për dhënie mendimi. Është një projektligj i sjellë nga qeveria. Relator i këtij projektligji do të jetë kolegu Alket Hyseni.

Nga Ministria e Brendshme kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Besfort Lamallari, zëvendësministër i Brendshëm, i cili është prezent në komision dhe zoti Shkëlzen Rexhepi, përfaqësues i Europolit.

Mirë se keni ardhur në komision!

Zoti Zëvendësministër, mund të bëni një prezantim të shkurtër të kësaj marrëveshjeje për kolegët e mi deputetë. Pastaj vazhdojmë me relatorin. Fjala është për ju.

Besfort Lamallari – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ju falënderojmë për mundësinë që na keni ofruar për të dhënë shpjegimet tona në lidhje me nevojën për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje të re me Europolin! Këto amendime janë propozuar në kuadër të ndryshimeve statutore të Europolit. Më 1 maj të vitit 2017 ka hyrë në fuqi rregullorja e re e Europolit dhe si rrjedhojë ka ndryshuar edhe kuadri ligjor i kësaj organizate. Mandati i ri i Europolit, mbulon vepra penale, të cilat kanë të bëjnë me krimet e rënda, terrorizmin dhe forma të tjera të krimit, të cilat prekin dy apo më shumë vende të BE-së, ashtu siç janë listuar në aneksin e parë të rregullores së re të Europolit. Në aneksin e parë të marrëveshjes janë vendosur fushat e krimit që mbulohen nga Europoli dhe konkretisht shtohen: terrorizmi, krimi i organizuar, krimet kundër interesave financiare të BE-së, manipulimi i brendshëm dhe manipulimi i tregut financiar, krimi mjedisor, duke përfshirë ndotjen nga anijet, abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, duke përfshirë materialet abuzive dhe joshëse ndaj fëmijëve për qëllime seksuale, si edhe genocidi, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e luftës.

Cilat janë benefitet e shtetit shqiptar me miratimin e kësaj rregulloreje, marrëveshjeje të re? Ajo do të kontribuojë më shumë për rritjen e bashkëpunimit në luftë kundër formave të reja të krimit të organizuar dhe krimit serioz në kuadër edhe të angazhimeve të ndërmarra nga shteti shqiptar në përmbushje të kritereve të përcaktuara në Marrëveshjen e Stabilizim -Asociimit për luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Duke iu referuar dispozitës përkatëse në ligjin nr.28 të vitit 2014, e cila përcakton marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane Europol për bashkëpunimin strategjik dhe europian, ish- drejtori ekzekutiv në vitin 2017 u ka drejtuar autoriteteve shqiptare një notë format bashkëlidhur projektvendimit me anë të të cilës kërkohet të përditësohet përmbajtja e aneksit të parë të marrëveshjes. Bazuar në nenin 25 të kësaj marrëveshjeje ratifikuar me ligjin e sipërpërmendur, kërkohet edhe ratifikimi i marrëveshjes së re.

Së pari, procedura kërkon të ratifikohet me ligj.

Më pas nota konfirmuese, e cila nënshkruhet nga ministri i Brendshëm, i përcillet organizatës së Europolit. Nga momenti që kjo e fundit merr në dorëzim këtë notë konfirmuese, quhet se marrëveshja ka hyrë në fuqi

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit!

Po, zoti Hyseni

Alket Hyseni - Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, suksese punës së këtij komisioni, i cili do të ketë një barrë të rëndë, sikurse e ka pasur edhe në sesionin e kaluar!

Së dyti, më lejoni në parantezë që këto urime t'ua përcillja edhe kolegëve të opozitës, të cilët për ligje të tilla të rëndësishme, siç është dhe ky projektligj që ka ardhur sot për shqyrtim për një ndryshim në marrëveshjen me një organizatë shumë të rëndësishme që është Europol, duhet të ishim këtu, sepse lufta ndaj krimit nuk bëhet në restorante me yje, apo në hotele me 5 yje ku mbledhen liderët e opozitës, nuk bëhet edhe vetëm në foltoren e SHQUP-it, por bëhet duke miratuar nisma të rëndësishme ligjore, duke miratuar marrëveshje me organizata partnere, duke stimuluar Policinë e Shtetit për të gjitha punët e mira, patjetër pse jo edhe duke e mbajtur atë nën presionin e kritikës për ato gjëra që nuk arrin t'i bëjë siç duhet në përputhje me ligjin.

Ne jemi të detyruar të vazhdojmë punën tonë, ky është destini i dhënë nga vota e popullit. Pra, me apo pa kolegët e opozitës ne do të vazhdojmë punën tonë për miratimin e ligjeve të rëndësishme për ta çuar Shqipërinë përpara drejt destinacionit të fundit që është BE-ja.

Më lejoni të paraqes disa momente lidhur me projektligjin. Sikurse parashtroi edhe zëvendësministri kjo është një nismë e Këshillit të Ministrave dhe vjen si pasojë e një marrëveshjeje vijuese me Europolin, marrëveshjeje, e cila në gjykimin tim personal ka qenë mjaft frytdhënëse nga ato informacione që kam. Do të shtoj edhe një pyetje konkrete për zëvendësministrin për t'ia bërë me dije të gjithë komisionit, por edhe opinionit publik, detajet rreth mënyrës së implementimit deri tani të kësaj marrëveshjeje, marrëveshjes aktuale, por duke qenë se Europol i është nënshtruar një reforme strukturore dhe statusore, gjë që ka bërë të mundur ndryshimin e disa elementeve funksionale të Europolit dhe duke qenë se marrëveshja lejon që të ketë shkëmbim notash për ndryshime të pjesshme të kësaj marrëveshjeje, në rastin konkret kemi të bëjmë me ndryshimin e aneksit 1 të kësaj marrëveshjeje, nga pikëpamja procedurale është tërësisht e ligjshme. Është paraqitur një notë nga drejtori i Interpolit dhe është konfirmuar nga Republika e Shqipërisë dhe pikërisht nga pikëpamja procedurale ligjore, në përputhje me detyrimet kushtetuese, kërkon kalimin e ligjit nga Kuvendi.

Ligji është në përputhje me Rregulloren nga pikëpamja e procedurës për shqyrtimin e tij. Në aspektin ligjor dhe procedural është në përputhje me Rregulloren dhe me Kushtetutën, kështu që unë do t'u kërkoja kolegëve miratimin e tij.

Ndërkohë, ministrit shkurtimisht po i drejtoj një kërkesë, nëse mund të na iluminonin konkretisht me kompetencat e fundit që ka Interpoli, pikërisht ndryshimet që paraqiten në këtë aneks.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Urdhëroni, zoti zëvendësministër!

Besfort Lamallari – I nderuar zoti Hyseni,

Në fakt, ju me të drejtë theksuat rëndësinë e zgjerimit të diapazonit të bashkëpunimit të ardhshëm me Europolin dhe veprat që janë përfshirë në këtë aneks të ri janë shumë të rëndësishme, e theksoj: terrorizmi, lufta kundër krimit të organizuar, krimi kundër interesave financiare të BE-së, manipulimi i brendshëm dhe manipulimi i tregut financiar, krimi mjedisor që përfshin ndotjen nga anijet, abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, si dhe gjenocidi dhe krimet kundër njerëzimit.

Zgjerimi i bashkëpunimit me Europolin është në interes të përbashkët të vendit tonë, por edhe vendeve anëtare, që do të thotë e perspektivës europiane të shtetit shqiptar dhe qytetarëve shqiptarë për të ardhur më pranë familjes europiane.

Cilat janë mundësitë e bashkëpunimit konkret? Janë përmes konsulencave, bashkëpunimit të ngushtë dhe të vazhdueshëm, oficerëve ndërlidhës, shkëmbimit të informacionit, mesazheve të përcjella përmes kanalit “Siena” dhe shumë e shumë instrumente të tjera të bashkëpunimit të sigurimit të të dhënave dhe transmetimit të tyre të sigurt.

Për më tepër, e parë se si kjo marrëveshje ka funksionuar, e cila dukshëm nga raportet e përcjella nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, ku është vendosur edhe Zyra Kombëtare Europol, duket trendi rritës nga viti në vit, megjithatë për më konkretisht dhe më kompetent po i lë fjalën përfaqësuesit të Zyrës Kombëtare të Europolit, zotit Rexhepi.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Rexhepi!

Shkelzen Rexhepi - Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ligjeve,

Siç e dini, ZKE-ja pranë Policisë së Shtetit funksionin në bazë të marrëveshjes aktuale për bashkëpunim strategjik dhe operacional.

Duke filluar nga ngritja e kësaj zyre e deri në momentet që flasim, bashkëpunimi me strukturat, me shtetet partnere në kuadër të shkëmbimit të informacionit me Europolin dhe zyrave homologe të Europolit në policitë e vendetë të BE-së, kryesisht, por edhe palëve të treta të cilat kanë marrëveshje analoge, siç është marrëveshja mbi të cilën funksionon zyra që unë drejtoj, ka njohur një rritje të vazhdueshme dhe në këtë rrethana edhe Europoli vetë, si institucion policor i BE-së, e ka parë të arsyeshme të zgjerojë fushën e veprimtarisë në mandatin e vet, duke zgjeruar më shumë kompetencat në hetimin, koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve ndërmjet shteteve anëtare dhe palëve të treta, siç është Shqipëria.

Ulsi Manja - Faleminderit!

A ka pyetje nga kolegët?

Urdhëroni, zoti Qefalia!

Xhemal Qefalia - Faleminderit!

Ju thatë në relacionin tuaj, por edhe në atë që relatori zoti zoti Hyseni u përmend, se kjo marrëveshje vjen si rezultat i hyrjes në fuqi të rregullores së re.

A keni informacion se cilat shtete e kanë nënshkruar këtë marrëveshje?

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Lamallari!

Besfort Lamallari – Për vendet e BE-së, sigurisht kjo është e dakordësuar dhe ka hyrë automatikisht në fuqi.

Për palët e treta, siç u përmend këtu, tani është momenti për Shqipërinë, por për vendet e tjera të rajonit nuk jam në dijeni dhe s'mund ta them me siguri.

Shkelzen Rexhepi - Në një procedurë analoge janë Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia. Aktualisht, nuk ka një marrëveshje operacionale të tillë Bosnja dhe për arsye që dihen as Kosova.

Ulsi Manja - Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të këtij projektligji.

Kush është dakord në parim?

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane Europol “Për bashkëpunim strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr. 28 të vitit 2014””.

Kalojmë në votimin nën për nën.

Neni 1.

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kalojnë në votimin në tërësi të këtij projektligji.

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane Europol “Për bashkëpunim strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr. 28 të vitit 2014””.

Ky projektligj së bashku me relacionin përkatës të kolegut Hyseni do t'i përcillet komisionit përgjegjës e më pas seancës plenare për ta votuar sipas kalendarit.

Faleminderit, zotërinj përfaqësues të Ministrisë së Brendshme!

Ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.09.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me kandidatët për anëtarë të komisionit të pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka.

Të ftuar:

Andi Muratej - kandidat
Artan Spahiu - kandidat
Gëzim Allaraj - kandidat
Iilir Kadiu - kandidat
Irena Nino - kandidate
Saimir Shehri - kandidat
Saimir Vishaj- kandidat
Suzana Pasha (Hoti)- kandidate
Lindita Rusmali- kandidate

Ulsi Manja - Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës, që është një seancë dëgjimore me kandidatët për anëtarë të komisionit të pavarur për koordinimin, monitorimin

dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115, të vitit 2016 “Për organet e qeverisjes dhe të sistemit të drejtësisë”.

Janë 9 kandidatë, që janë thirrur në këtë seancë dëgjimore dhe që kanë paraqitur pranë komisionit dokumentacionin përkatës të kërkuar sipas ligjit, por edhe të vendimit të Kuvendit.

Përpara se t’i ftojme kandidatët në seancë dëgjimore, do t’u kërkoja kolegëve të vendosim një afat kohor në dispozicion të secilit kandidat. Unë propozoj 5 minuta.

(Diskutime pa mikrofon)

Ta lëmë të hapur, maksimumi deri në 5 minuta. Besoj se është mjaftueshëm, sepse kandidatët e paraqitur kanë njohuri të thelluara për paketën e reformës në drejtësi, por edhe për zbatimin e kësaj reforme.

Është bërë një renditje e kandidatëve sipas rendit alfabetik, ndërkohë që njëri nga kandidatët për arsye kohë ka kërkuar të pyetet në fund.

Urdhëroni, Andi Murataj!

Përshëndetje! Ju jeni njëri nga kandidatët në garë për të qenë pjesë e komisionit të pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115, të vitit 2016 “Për organet e qeverisjes dhe të sistemit të drejtësisë”.

Dokumentacioni juaj është në dispozicion të kolegëve deputetë, por edhe të kolegëve të opozitës që sot mungojnë.

Në këtë seancë dëgjimore komisioni ka vendosur që minutazhi në dispozicion për të shpalosur arsyet se çka ju shtyn ju të jeni pjesë e kësaj gare, është maksimumi 5 minuta. Do t’ju lutesha t’i përmbliidhni në mënyrë të shkurtuar ato çfarë ju sot do të thoni para kolegëve.

Fjala është për ju.

Andi Murataj – Përshëndetje, të nderuar anëtarë të Komisionit të Ligjeve!

Quhem Andi Murataj.

Për t’iu përgjigjur pyetjes që më bëri kryetari i Komisionit të Ligjeve po bëj një prezantim të shkurtër të vetes, për të kaluar pastaj edhe te arsyeja e kandidimit tim për anëtar të komisionit të pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115, të vitit 2016 “Për organet e qeverisjes dhe të sistemit të drejtësisë”.

Jam diplomuar në vitin 2001 në Fakultetin e Drejtësisë në Tiranë me rezultate shumë të mira. Që nga koha e studimeve, por edhe më vonë, nga viti 1997-2003 jam angazhuar me Komitetin Shqiptar të Helsinkit si vëzhgues apo si specialist në projektet që ka zhvilluar kjo organizatë në fushën e të drejtave të njeriut.

Gjithashtu, në vitin 2002 kam marrë licencën e avokatisë pas provimit të zhvilluar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Në vitin 2004 deri në vitin 2010 kam punuar në Ministrinë e Drejtësisë në detyra të ndryshme në aparatën qendror të Ministrisë së Drejtësisë në detyra të ndryshme si specialist, inspektor, përgjegjës sektori dhe më pas kam punuar për një kohë të shkurtë si inspektor jurist në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, ish- INUK-u.

Nga viti 2014 dhe aktualisht kontribuoj në shoqërinë civile si avokat, si menaxher projektsh dhe si ekspert ligjor. Për t'u përmendur janë kurset pasuniversitare që kam kryer në fushën e të drejtave të njeriut. Sikurse edhe kurset që kam bërë në vitin 2004 që ka të bëjë me qeverisjen vendore, po ashtu kursi që kam përfunduar në vitin 2006, kursi i zhvilluar në qendrën Europiane për Studime të Avancuara në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes në qendrën "Xhorxh Marshall" në Gjermani. Po ashtu, kam përfunduar edhe kurse të tjera për menaxhim projektsh apo për studime të tjera në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes.

Gjatë eksperiencës në Ministrinë e Drejtësisë kam mbuluar Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe më vonë, pas krijimit të saj në vitin 2008, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

Në këtë periudhë pjesë e rëndësishme e punës sime kanë qenë zbatimi i rregullave standard për personat e privuar nga liria, të miratuara nga OKB-ja, rregullat Europiane të Burgjeve, rekomandimet e Komitetet për Parandalimin e Torturës, rekomandimet e Avokatit të Popullit, gjithashtu pjesë e rëndësishme e kësaj eksperience në Ministrinë e Drejtësisë ka qenë edhe kontributi në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore që e mbulonin fushën e trajtimit të personave të privuar nga liria.

Në pjesë tjetër e rëndësishme e eksperiencës sime në shoqërinë civile është ajo ku aktualisht kontribuoj, angazhimi im si avokat ekspert dhe menaxher projektsh.

Me rëndësi të veçantë janë përfaqësimi i çështjeve ...

Ulsi Manja – Zoti Murataj, më falni që po ju ndërhyj, por lidhur me CV-në tuaj kolegët janë të informuar, prandaj problemi është të fokusoheni tek ajo për të cilën ju konkurrioni.

Andi Murataj – Angazhimi në shoqërinë civile shkon natyrshëm me punën e këtij komisioni me qenë se edhe shoqëria civile përbën një mekanizëm të jashtëm dhe të pavarur për vëzhgimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, prandaj në këtë aspekt eksperiencia në shoqërinë civile, kontributi dhe aktivizimi në shoqërinë civile shkon më së miri me misionin që ka ky komision që është monitorimi i përzgjedhjes së kandidatëve,

si dhe i procedurave të zgjedhjes dhe të emërimit të anëtarëve të organeve të reja të qeverisjes në sistemin e drejtësisë.

Po ashtu koordinimi i institucioneve është një nga detyrat e tjera të këtij komisioni, koordinimi i institucioneve që parashikon ligji nëpër organet e sistemit të drejtësisë, si dhe raportimi pranë Komisionit të Ligjeve sa herë është e nevojshme në lidhje me zbatimin e detyrimeve që kanë organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë në kuadrin e këtij ligji për zbatimin e plotë të reformës në sistemin e drejtësisë.

Gjendja e sistemit të drejtësisë dihet tashmë dhe shkak janë problematikat shumë të rënda që paraqiti sistemi i drejtësisë të evidentuara edhe në raportet ndërkombëtare, u bë e domosdoshme ndërmarrja e një reforme rrënjësore. Problemet më të rënda kishin të bënin me keqfunksionimin, mungesën e transparencës, me shkallën e ulët e profesionalizmit, mungesën eficiencës, mungesën e pavarësisë dhe të gjitha këto probleme bënë që Kuvendi i Shqipërisë të ndërmerre nismën për të realizuar në reformë, që e preku tërësisht gjithë sistemin në të gjithë komponentët që përbëjnë sistemin e drejtësisë.

Për këtë arsye në vitin 2014 u ngrit Komisioni i Posaçëm i Reformës në Sistemin e Drejtësisë, i cili u asistua nga grupi i ekspertëve vendas dhe të huaj të nivelit të lartë, si dhe sekretariati teknik i Kuvendit, i cili siguroi punën mbështetëse logjistike. E rëndësishme është që kjo reformë në drejtësi në radhë të parë preku të gjitha aspektet komponentë të sistemit të drejtësisë.

Së dyti, aty kontribuan të gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë, gjyqtarë, prokurorë, shoqëria civile, grupet e interesit, partnerët ndërkombëtarë. Pra, pati një përfshirje shumë të gjerë.

Së treti, nuk është thjesht një reformë teknike, por ka edhe karakter social, ka edhe karakter politik, pasi kjo reformë synon të krijojë një sistem drejtësie, i cili të mund të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të vendit, por edhe integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Gjendja aktuale e sistemit të drejtësisë, meqenëse reforma akoma s'ka filluar të zbatohet plotësisht, për të folur pastaj edhe për frytet e saj, pra gjendja e keqe në sistemin e drejtësisë u bë shkak e pengesë për integrimin e vendit në Bashkimin Europian. Për rrjedhojë, duke pasur parasysh angazhimin tim në shoqërinë civile, shpreha interesin për të qenë anëtar i këtij komisioni, për të kontribuar, e sigurisht edhe për të pasur një njohje më të mirë, pasi me punë e me eksperiencë përmirësohen njohuritë, por gjithashtu edhe për efekt të një CV-je më të mirë profesionale.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Murati!

Ka pyetje nga kolegët? Me sa duket nuk ka pyetje nga kolegët.

Shumë faleminderit! Ditë të mbarë!

Vazhdojmë me kandidatin tjetër në radhë, Artan Spahiu.

Përshëndetje, zoti Spahiu! Mirë se erdhët në komision!

Jeni sot këtu, në një seancë dëgjimore nga interesi që keni shprehur për të qenë pjesë e Komisionit të pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit numër 115 të vitit 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. I gjithë dokumentacioni i paraqitur nga ana juaj është në dispozicion të kolegëve. Unë do t’ju lutesha që, shkurtimisht, sipas kohës së përcaktuar që është vënë në dispozicion për secilin kandidat, kohë që shkon deri në pesë minuta, të shpalosni para komisionit arsyet që ju shtyjnë të jeni pjesë e kësaj gare, si dhe cilat janë njohuritë tuaja në lidhje me reformën në drejtësi dhe zbatimin e kësaj reforme.

Fjala është për ju!

Artan Spahiu – Ju faleminderit!

Të nderuar zotërinj deputetë,

Të nderuara zonja deputete,

Unë quhem Artan Spahiu. Jam dyzet e një vjeç, banues në Elbasan, aktualisht pedagog në Departamentin e së Drejtës, në Fakultetin Ekonomik të Universitetit “Aleksandër Xhuvani”.

Kam një karrierë pune tetëmbëdhjetëvjeçare si në administratë publike ashtu edhe në fushën akademike. Gjithashtu jam autor i disa librave dhe i disa punimeve akademike.

Jam njohur me shpalljen që ju keni bërë në lidhje me plotësimin e Komisionit të pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit 115. Gjykoj se kjo është një reformë shumë e rëndësishme për vendin tonë. Në fakt, kam pasur dëshirë të marr pjesë që në procesin e zgjedhjes së anëtarëve të komisioneve të pavarura të kualifikimit, por me thënë të drejtën kam hezitur.

Gjithsesi, mendoj se do të jap kontributin tim në këtë reformë. Për sa u përket njohurive të mia mbi ligjin, për aq sa e kam konsultuar, gjykoj se fryma e nenit 288 të ligjit 115 synon t’i japë Kuvendit një siguri të arsyeshme dhe objektive mbi procesin përzgjedhës të kandidatëve në të gjitha organet që qeverisin pushtetin gjyqësor, të cilat janë: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Inspektori i lartë i Drejtësisë, si dhe Shkolla e Magjistraturës.

Pra, Kuvendi që kërkon një siguri të arsyeshme që ky proces po realizohet drejt, që këto afate po respektohen, që këto procedura janë zhvilluar mbi bazën e parimeve që vetë ligji sanksionon, të cilat janë: transparenca, efienca dhe llogaridhënia. Këtë siguri të arsyeshme Kuvendi synon ta marrë nëpërmjet një komisioni të pavarur ekspertësh, ku synoj të bëj pjesë edhe unë.

Kam eksperiencë në organet e administratës publike dhe ato akademike, kam punuar dhjetë vjet në organet e auditimit, jam audit i brendshëm në sektorin publik, jam avokat, jam ndërmjetës i licencuar. Të verifikuarit, të monitoruarit, procesi i koordinimit ka qenë një pjesë e aktivitetit që unë kam zhvilluar, ndaj gjykoj se do të mund të jap kontributin tim në këtë drejtim.

Nuk e di sa isha i saktë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Spahiu!

A kanë pyetje kolegët për zotin Spahiu?

Po, zonja Hysi ka pyetje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Spahiu! Faleminderit që i jeni përgjigjur kërkesës dhe keni shprehur interesin në përgjigje të aplikimit që ka botuar Kuvendi i Shqipërisë!

Ky mekanizëm është shumë i rëndësishëm për të bërë monitorimin dhe koordinimin e punës midis shumë institucioneve që do të zbatojnë ligjin “Për organet e qeverisjes”.

Unë kam një pyetje: sa i familjarizuar jeni ju në lidhje me reformën në drejtësi? A keni pasur mundësi të ndiqni procesin e draftimit, të konsultimit, të paketës së ligjeve, e dhe kur ky diskutim është bërë në qytetin e Elbasanit? A keni pasur mundësi të shprehni mendimet dhe opinionet tuaja nëpërmjet faqes së hapur posaçërisht për konsultimin publik.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Artan Spahiu – Ju faleminderit!

Unë, së bashku me kolegët e mi pedagogë të së drejtës në Universitetin e Elbasanit kemi marrë pjesë në një takim të hapur, që është zhvilluar bashkë me përfaqësues ndërkombëtarë për procesin e reformës në drejtësi. Kemi shprehur opinionet tona aty, kemi dhënë mendime me shkrim, kur na është kërkuar nga ana e Kuvendit, kemi marrë pjesë në takimin që është *aula magna* të Universitetit të Elbasanit në lidhje me reformën në drejtësi, kemi marrë pjesë dhe kemi organizuar në Fakultetin Ekonomik një takim me ministren e Drejtësisë në lidhje me procesin e reformës në drejtësi, ku i kemi folur studentëve për këtë reformë.

Unë nuk jap lëndën “e drejtë publike” apo “e drejtë kushtetuese”, por gjithsesi jam pjesë e departamentit, jam edhe zëvendësdekan i fakultetit, e normalisht kam marrë pjesë edhe në hartimin e kurrikulës së kësaj lënde, kështu që domosdoshmërisht jam i njohur me procesin e reformës.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Faleminderit për prezencën tuaj në komision, zoti Spahiu! Ditë të mbarë!

Artan Spahiu – Ju faleminderit!

Ulsi Manja – Vazhdojmë me kandidatin tjetër në radhë, zotin Gëzim Allaraj.

Zoti Allaraj, mirë se erdhët në Komisionin e Ligjeve!

Ju keni shprehur interesin për të qenë njëri nga kandidatët në garë për Komisionin e pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit 115 të vitit 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Në mos gaboj, nuk e keni për herë të parë që vini në një seancë dëgjimore. Kolegët e kanë dokumentacionin tuaj mbi tavolinë, së bashku me dokumentet e kërkuara nga ligji.

Do t’ju lutesha që, shkurtimisht, sipas minutazhit kohor të përcaktuar për të gjithë kandidatët, pra deri në pesë minuta, të shpalosni para kolegëve të komisionit arsyet që ju shtyjnë për të qenë pjesë e kësaj gare.

Fjala është për ju!

Gëzim Allaraj – Ju faleminderit, zoti kryetar i Komisionit të Ligjeve,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Në fakt, unë e kam për herë të parë që vij në një seancë dëgjimore, kështu që...

Ulsi Manja – Atëherë tërhiqem.

Gëzim Allaraj – Unë kandidoj për të qenë anëtar i Komisionit të pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit 115 të vitit 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Pasi jam njohur me kushtet dhe kriteret, kam kandiduar, meqenëse mendoj se i plotësoj kushtet dhe kriteret ligjore për të qenë një nga anëtarët e këtij komisioni të pavarur.

Për sa i përket përvojës dhe eksperiencës time, dua të theksoj se unë jam diplomuar në vitin 1998 në sistemin me kohë të plotë. Që nga viti 2000 kam ushtruar profesionin e avokatit në mënyrë të pandërprerë. Vazhdoj ta ushtroj këtë profesion. Nuk jam shkëputur asnjëherë. Nuk kam qenë asnjëherë në administratë, në funksione politike, si dhe nuk jam angazhuar në parti politike. Prej disa vitesh jam kryetar i Unionit të Juristëve të Pavarur të

Shqipërisë. Kjo është një organizatë, një bashkim vullnetar juristësh, që kryesisht ka si fushë veprimtare mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, pavarësinë e pushtetit gjyqësor, luftën kundër abuzimit me pushtetin dhe luftën kundër korrupsionit.

Për shkak të eksperiencës sime si drejtues i kësaj organizate dhe eksperiencës së ushtrimit të profesionit të avokatit, duke njohur mirë problemet që lidhen me të drejtat e njeriut, me procedurat që kanë të bëjnë me ushtrimin e pushtetit gjyqësor, duke njohur mirë edhe aktet ndërkombëtare e legjislacionin e mëparshëm, por edhe legjislacionin e ri për reformën në drejtësi, mendoj të jap kontributin tim, duke u nisur nga përvoja që buron nga misioni i shoqërisë civile. Unë jam një misionarët e shoqërisë civile.

Gjithashtu, dua të theksoj se gjatë punës sime si avokat nuk kam pasur asnjëherë ndonjë masë disiplinore, e madje nuk ka pasur asnjë ankesë nga klientët e mi, as edhe një ankesë të vetme. Kjo tregon përpikërinë time në profesionin e avokatit, kështu që dëshiroj të jap kontributin tim.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Allaraj!

Ka pyetje nga kolegët?

Zonja Hysi ka pyetje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Allaraj! Faleminderit që keni pranuar të aplikoni dhe t'i përgjigjeni thirrjes që ka shpallur Kuvendi i Shqipërisë për të qenë anëtar i Komisionit të pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të një ligji shumë të rëndësishëm.

Nga dokumentacioni që na keni dorëzuar dhe na keni vënë në dispozicion, unë do të doja të dija pak më shumë në lidhje me eksperiencën tuaj të punës nga viti 1998, kur keni përfunduar studimet, e deri më sot. keni punuar gjatë gjithë kohës avokat, apo keni kryer edhe detyra të tjera? E para kjo.

E dyta: meqenëse në dosjen tuaj nuk ka informacion nga dhoma e avokatisë, nëse keni pasur ndonjë masë disiplinore apo jo. Do të doja ta dëgjoja këtu nëse keni pasur ndonjë masë disiplinore apo nëse jeni larguar nga detyra për shkaqe disiplinore. Është një kërkesë...

Gëzim Allaraj – Ju faleminderit, zonja anëtare e komisionit! Atëherë, unë...

Ulsi Manja – Një sekondë, të lutem! Ta mbarojë pyetjen!

Vasilika Hysi – E treta, dua të di diçka më shumë lidhur me aktivitetin shkencor e botues për çështje që kanë të bëjnë me reformën në drejtësi.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Fjala është për ju, zoti Allaraj! Ju lutem, shkurtimisht!

Gëzim Allaraj – Për sa u përket dy pyetjeve të para, unë fola pak a shumë në mënyrë të përmbledhur. Unë kam ushtruar profesionin e avokatit, por gjithashtu kam angazhime në shoqërinë civile. Pra, nuk kam ushtruar ndonjë detyrë tjetër administrative, shtetërore ose politike.

Gjithashtu, e theksova se ndaj meje nuk ka pasur asnjëherë ndonjë ankesë nga klientët ose nga gjyqtarët, sa i takon etikës apo ndonjë problemi tjetër. S'ka ndodhur as edhe një herë të vetme. Pra, nuk ka pasur ndonjëherë ndonjë masë disiplinore e as ka aktualisht.

Fusha e veprimtarisë sime janë të drejtat e njeriut, si misionar i shoqërisë civile që jam. Kjo është një nga pikat dhe kriteret në lidhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu, kam artikuj të botuar, që kanë të bëjnë me sistemin e drejtësisë, me të drejtat e njeriut. Kam qenë vazhdimisht pro reformës në drejtësi, ku kam dhënë kontributin tim me aq sa kam pasur mundësi.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Allaraj!

Ka pyetje nga kolegët e tjerë? Nuk ka.

Faleminderit, zoti Allaraj!

Gëzim Allaraj – Ju faleminderit, zoti kryetar!

Ulsi Manja – Ditë të mbarë dhe suksese!

Kandidati tjetër në radhë është Ilir Kadiu.

Zoti Kadiu, mirëserdhët në Komisionin e Ligjeve!

Jeni njëri nga kandidatët që keni shprehur interesin për të qenë pjesë e Komisionit të Pavarur të Monitorimit, Koordinimit dhe Zbatimit të Ligjit për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë.

Si për të gjithë kandidatët, edhe për ju vlen i njëjti rregull. Koha në dispozicion është përcaktuar deri në 5 minuta. I gjithë dokumentacioni i kërkuar, sipas vendimit të Kuvendit, është në dispozicionin e kolegëve, ndaj do t'ju lutesha shkurtimisht të fokusoheni tek arsyet që ju shtynë të bëheni pjesë e kësaj gare.

Fjala është për ju.

Ilir Kadiu – Përshëndetje të gjithëve!

Duke parë rëndësinë që ka kjo reformë kaq e madhe dhe e thellë në sistemin tonë të drejtësisë, por jo vetëm, si çdo jurist tjetër, do të ishte nder dhe privilegj që të bëhesha pjesë e kësaj reforme, në një kohë kur gjykohet se është një ndër reformat e thella në historinë e shtetit shqiptar në fushën e drejtësisë.

Në konsultimet e bëra bashkë me kolegët juristë, kemi paraqitur pikëpamjet tona për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të kësaj reforme, por tani që na jepet rasti të bëhemi vetë aktorë, pra të mos mbetemi vetëm në kuadrin e diskutimeve në rrethet tona prej juristësh, gjykoj se ka ardhur koha të japim kontributin tonë sado modest në ngritjen dhe funksionimin e këtyre organeve të reja, që janë shumë të rëndësishme dhe themelore për funksionimin e reformës në drejtësi.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Ka pyetje nga kolegët?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Kadiu, për pjesëmarrjen tuaj në këtë intervistë dhe që pranoni të kandidoni për një komision shumë të rëndësishëm!

Kam një pyetje lidhur me aktivitetin tuaj kërkimor-shkencor në fushën e drejtësisë: mund të na thoni diçka më tepër se cili është kontributi juaj studimor pasuniversitar dhe kërkime-studime në fushën e drejtësisë?

Faleminderit!

Ilir Kadiu – Kam ndjekur dhe përfunduar një master për të drejtat administrative, ku udhëheqës teme kam pasur profesor Sokol Sadushin. Tema ka qenë “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative” rreth vitit 2010-2011, e cila ka qenë një eksperiencë e mirë pasi më ka shërbyer dhe vlejtur për të thelluar njohuritë e mia kryesisht në të drejtën administrative dhe në gjykimin e marrëveshjeve administrative.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Zoti Kadiu, konstatoj se kjo vlen për të gjithë kandidatët, edhe këshilltarët ta mbajnë shënim, shoh që janë disa dokumente që mungojnë në dosjen tuaj dhe do t’ju lutesha që, pasi të mbaroni këtë seancë dëgjimore, të kontaktonit me sekretarinë dhe t’i dorëzoni, në rast se i keni...

Ilir Kadiu – I kam dorëzuar përpara...

Ulsi Manja - Po, sapo i keni dorëzuar një pjesë të tyre...

Këtë do ta kërkoja nga të gjithë kandidatët, që dokumentet që mungojnë dhe që i kanë sjellë sot me vete, t’i depozitojnë pranë sekretarisë së komisionit.

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Nuk ka!

Faleminderit, zoti Kadiu! Ditë të mbarë!

Vazhdojmë me kandidaten tjetër në radhë, zonjën Irena Nino.

Mirëserdhët në komision, zonjë!

Jeni një nga kandidatët në garë që keni shprehur interesin për të qenë pjesë e Komisionit të Pavarur të Monitorimit, Koordinimit dhe Zbatimit të Ligjit nr. 115 të vitit 2016 për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë.

Dokumentacioni që keni paraqitur, sipas kërkesave të vendimit të Kuvendit, është i plotë dhe ndodhet përpara të gjithë kolegëve të mi deputetë, ndaj do t'ju lutesha që brenda minutazhit prej 5 minutash që kemi përcaktuar për të gjithë kandidatët, në mënyrë të përmbledhur të shpalosni para kolegëve të komisionit, por edhe para mediave se cilat janë arsyet që ju shtynë të bëheni pjesë e kësaj gare, shkurtimisht.

Fjala është për ju!

Irena Nino – Ju përgjigja thirrjes së Kuvendit për të aplikuar në Komisionin e Pavarur të ngritjes së organeve të reja të drejtësisë, për arsye se kam një përvojë 20-vjeçare në organin e prokurorisë.

Kam përfunduar studimet në sistemin e drejtësisë në vitin 1985 dhe kam punuar 6 vjet në Prokurorinë e Shkodrës, 7 vjet e gjysmë në Prokurorinë e Përgjithshme dhe rreth 4 vjet në Prokurorinë e Tiranës. Më pas, kam marrë licencën e avokates, të cilën e kam ushtruar me kohë të pjesshme.

Duke qenë se reforma në drejtësi ishte gjëja më e mirë që mund t'i ndodhte këtij vendi, duke parë gjendjen ku kishte përfunduar sistemi i drejtësisë dhe duke parë që kompleksi i kuadrit ligjor pothuajse u përfundua, mendova të jap edhe unë kontributin tim në këtë komision, pasi mendoj se kam eksperiencën e nevojshme në organet e drejtësisë.

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Nino!

Ka pyetje nga kolegët? Po, zoti Fino.

Bashkim Fino - Faleminderit, zonja Nino, që keni ardhur!

CV-ja juaj është shumë e pasur dhe do të doja të bëja një pyetje për të qenë i qetë me veten time: ju keni dhënë dorëheqjen më 23.03.2004 nga prokuroria. Çfarë ju shtyn të vini të rikandidoni tani si anëtare e komisionit, pasi keni ikur që në vitin 2004?

Irena Nino – Në atë kohë dhashë dorëheqjen për arsye objektive, pasi kisha tim shoq të sëmurë, por nga sistemi i drejtësisë nuk jam ndarë asnjëherë shpirtërisht. Vazhdimisht kam ndjekur zhvillimet e reja dhe mendova se ky do të ishte momenti i duhur për të rikandiduar, për të dhënë kontributin tim modest në ngritjen e organeve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Ulsi Manja - Pra, zonja Nino, më tepër për ta fiksuar për efekt rekordesh, arsyeja e dorëheqjes nga prokuroria në vitin 2004 ka qenë arsye objektive shëndetësore e bashkëshortit tuaj?

Irena Nino – Po, arsye shëndetësore, asnjë problem tjetër, madje, nëse do të shikoni letrat e prokurorisë, analizën e vitit 2003, pavarësisht se isha femër dhe me fëmijë të vegjël, kisha ngarkesën më të lartë të punës, si dhe cilësinë shumë të mirë, pasi nuk kisha asnjë vendim të prishur nga Gjykata e Lartë apo nga Gjykata e Apelit. Kisha një punë cilësore, gjë e cila mund të verifikohet.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Nino, për përgjigjen që i bëtë ftesës së Kuvendit të Shqipërisë!

Kam një pyetje: sa keni mundur ta ndiqni reformën në sistemin e drejtësisë?

Irena Nino – Aktivisht nuk e kam ndjekur, sepse kam qenë jashtë saj, megjithatë kam studiuar të gjitha ligjet dhe me aq sa kam pasur mundësinë ta ndjek, e kam ndjekur hap pas hapi, çdo moment.

Ulsi Manja - Ka pyetje të tjera? Nuk ka!

Faleminderit, zonja Nino!

Ditë të mbarë!

Vazhdojmë me kandidatin tjetër të garës, zotin Saimir Shehri.

Mirëserdhët në Komisionin e Ligjeve në këtë seancë dëgjimore! Jeni njëri nga kandidatët që keni shprehur interesin për të qenë pjesë e Komisionit të Pavarur të Monitorimit, Koordinimit dhe Zbatimit të Ligjit nr. 115 të vitit 2016 për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë.

Në fakt, dosja juaj me dokumentet e kërkuara, sipas ligjit dhe vendimit të Kuvendit, është mbi tryezën e kolegëve të mi deputetë, ndaj brenda këtij minutazhi kohor që kemi përcaktuar për të gjithë kandidatët deri në 5 minuta, do t'ju lutesha të shpalosni para komisionit arsyet që ju shtynë për të qenë pjesë e kësaj gare.

Saimir Shehri – Ju falënderoj, zoti kryetar!

Arsyeja e kandidimit tim në këtë komision është një e vetme, të jap kontributin tim, sado modest, në reformimin e sistemit të drejtësisë.

Ulsi Manja - Kanë pyetje kolegët?

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Përshëndetje, zoti Shehri!

Keni qenë anëtar i ndonjë forumi të lartë të partive politike gjatë viteve të fundit?

Saimir Shehri – Jo, nuk kam qenë!

Ulsi Manja - Ka pyetje të tjera nga kolegët për zotin Shehri? Nuk ka mesa duket.

Faleminderit, zoti Shehri, për prezencën tuaj!

Ditë të mbarë!

Vazhdojmë me kandidatin tjetër në radhë, zotin Saimir Vishaj.

Mirëserdhët në Komisionin e Ligjeve, zoti Vishaj!

Saimir Vishaj - Përshëndetje! Faleminderit!

Ulsi Manja – Ju jeni njëri nga kandidatët që keni shprehur interesin për të qenë pjesë e Komisionit të Pavarur të Monitorimit, Koordinimit dhe Zbatimit të Ligjit nr. 115 të vitit 2016 për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë.

Në fakt, dosja juaj është e plotë me gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit dhe vendimit të Kuvendit, e cila u është vendosur në dispozicion të gjithë kolegëve. Natyrisht, jeni edhe një person i prononcuar herë pas here lidhur me reformën në drejtësi dhe ecurinë e saj, ndaj do t’ju lutesha shkurtimisht, brenda minutazhit të përcaktuar prej 5 minutash, të shpalosni edhe një herë arsyet që ju shtynë për të qenë pjesë e kësaj gare, por edhe lidhur me njohuritë tuaja për reformën në drejtësi dhe zbatimin e saj.

Fjala për ju.

Saimir Vishaj - Jam prej 22 vjetësh avokat. Njëkohësisht jam edhe pedagog i brendshëm në Universitetin “Luarasi”. Gjatë viteve të fundit kam qenë pjesëmarrës në tryezat që janë bërë në lidhje me reformën në drejtësi. Jam munduar të kandidoja edhe për Këshillin e Lartë Gjyqësor, por për arsye subjektive hoqa dorë, për shkak edhe të pjesëmarrësve, të cilët kishin papajtueshmëri interesash. Mendoj se ky komision duhet të ishte ngritur para ose njëkohësisht me daljen e ligjit nr. 115 të vitit 2016, ku disa subjekte kishin papajtueshmëri si anëtarë të KLGJ-së apo të KLP-së, dhe, fatkeqësisht, ai moment përfundoi me gogla.

Jam munduar jo vetëm individualisht, por edhe me shoqatën që drejtoj të jemi pro reformës, ashtu siç jemi në këto momente që kjo reformë ka dhënë sukseset e para, kur jo vetëm ne si avokatë, jo vetëm qytetarët, por edhe gjyqtarët janë tronditur kur në rrjetën e reformës kanë rënë gjyqtarë të lartë, për të cilët është për të ardhur keq, që kanë qenë të dënuar me burgim për vepra penale shumë të pështira për sistemin e drejtësisë, siç është

vjedhja, ashtu siç kemi aktualisht edhe gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët kanë qenë të arrestuar për vepra penale.

Përvoja ime, duke iu përgjigjur thirrjes së Kuvendit të Shqipërisë, do të ndihmojë jo vetëm në monitorimin dhe koordinimin, por edhe në përjashtjen e zgjedhjeve dhe emërimeve që do të ketë në KED ose në organet e qeverisjes që kanë dalë në bazë të ligjit, mendoj që do të jetë një ogur i mirë ku ne do të kemi kontakte shumë të mira me Komisionin e Ligjeve dhe organet e qeverisjes gjyqësore.

Mendoj se jemi në kohë që parlamenti të mos i mësojë ecuritë e reformës nëpërmjet shtypit apo medias, por ky komision të jetë zëri, syri dhe veshi për qeverisjen gjyqësore, në mënyrë që këtë reformë që kemi nisur ta përfundojmë me sukses brenda të gjithë parametrave për të kthyer besimin te qytetarët dhe për të arritur atë objektiv që kemi të gjithë që sundimi i ligjit të jetë në të gjitha sferat e shoqërisë shqiptare.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Vishaj!

Ka pyetje nga kolegët? Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Vishaj, për pranimin e kandidimit për të qenë pjesë e këtij komisioni! Ndërkohë, dua t'ju falënderoj për të gjithë punën e bërë që nga miratimi i Komisionit të Reformës së Drejtësisë, për formimin e avokatëve dhe profesionistëve lidhur me ligjet e reja.

Krahas aktivitetit që na është dashur ta ndjekim kur ka qenë publik, prandaj do të doja të dija diçka më shumë për aktivitetin tuaj, për ecurinë e reformës në drejtësi, pasi ligjet janë miratuar, përveç trajnimeve të avokatëve që keni bërë për drejtësinë e të miturve dhe gjithçka tjetër që lidhet me këtë. Pra, cili është aktiviteti juaj konkretisht në këtë fushë? Duke u nisur nga përvoja juaj, pse duhet që ne t'ju votojmë dhe çfarë do t'i sillni këtë komisioni në vlerë të shtuar?

Faleminderit!

Saimir Vishaj – Faleminderit!

Gjatë 22 vjetëve të punës sime e kam prekur sistemin gjyqësor qoftë në gjyqësor apo në prokurori, prandaj mendoj se këto janë të mjaftueshme, duke bërë një krahasim ku ishim, atë çfarë ka prodhuar shkolla 6-mujore, atë çfarë na u desh të bënim dhe sot me zbatimin e ligjit dhe ndryshimet kushtetuese them se rezultatet e para janë dhënë, jo vetëm në reformën për drejtësinë penale, por për të gjithë reformën në drejtësi, ku aktualisht shumë gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët nuk e meritonin të ishin pjesë e administratës e jo më pjesë e gjyqësorit u larguan. Besoj se kjo reformë po e dërgon atë tren në shinat e duhura.

Sot ne u jemi përqasur ligjeve parimore, të cilat ju po i miratoni, edhe pse ka disa ligje, të cilat me të vërtetë janë bashkëkohore, por momenti me të cilin u vunë me shpejtësi në zbatim e gjeti të papërgatitur trupën gjyqësore, trupën e prokurorëve apo trupën e avokatisë për zbatimin e këtij ligji. Sipas mendimit tim ligjet që ju keni miratuar janë shumë të mira dhe bashkëkohore, por duan momentin e tyre për t'u realizuar në praktikë, për shkak se përveç daljes së ligjit ne veprojmë edhe me precedentë, sepse na duhet funksionimi i Gjykatës së Lartë, për të cilin duhet që disa papajtueshmëri, mosnjohje apo rakordim të disa normave ligjore të kemi edhe njësimin e tyre në praktikë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Vishaj!

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Nuk ka.

Zoti Vishaj, faleminderit dhe ditë të mbarë!

Saimir Vishaj – Faleminderit edhe juve dhe suksese!

Ulsi Manja - Vazhdojmë me kandidaten tjetër në radhë, zonjën Suzana Pasha Hoti.

Zonja Pasha, mirë se erdhët në Komisionin e Ligjeve në këtë seancë dëgjimore!

Ju keni shprehur interesin për të qenë anëtare e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115, të vitit 2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Dokumentacioni juaj është i plotë dhe gjendet në tryezën e Komisionit të Ligjeve, ku të gjithë kolegët e kanë mbi tavolinë, ndaj do t'ju lutesha që brenda minutazhit që kemi përcaktuar për të gjithë kandidatët të na tregonit arsyen që ju shtyn të jeni pjesë e kësaj gare, por edhe diçka lidhur me njohuritë tuaja për reformën në drejtësi dhe zbatimit e kësaj reforme.

Fjala për ju.

Suzana Pasha (Hoti) – Përshëndetje kryetar!

Të nderuar anëtarë,

Unë jam Suzana Pasha. Kam mbaruar arsimin e lartë juridik dhe kam punuar si ndihmësgjyqtare për një periudhë prej 6 vjetësh në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat dhe pasi ky vend pune u suprimua kam konkurruar dhe që nga ajo ditë në qershor të vitit 2001 e deri më sot punoj si avokate me numër licence 1122.

Fakti që më shtyu të konkurroj dhe të shpreh interes duke kandiduar për vendin e shpallur si anëtar i Komisionit të Pavarur të Koordinimit, Kualifikimit dhe Monitorimit në zbatim të ligjit nr. 115/2016 është fakti se unë profesionin tim e dëshiroj dhe e dashuroj.

Fakti që e dëshiroj dhe e dashuroj është një ndër arsyet, sepse gjithmonë kam punuar në profesionin tim dhe nuk jam larguar për asnjë moment. Duke qenë pjesë e profesionit dhe pjesë e sistemit gjyqësor, pasi edhe avokati është një subjekt procedural i mbrojtjes së lirive të shtetasve dhe individit. Pra, duke qenë një subjekt procedural mendoj se i njoh konsiderueshëm problemet e sistemit të drejtësisë, duke pasur moshën dhe aftësisë e duhura profesionale, si dhe duke e njohur mirë punën në grup, mendoj që mund të jem një ndër kandidatet për Komisionin e Pavarur të Koordinimit, Monitorimit dhe Zbatimit e Funkcionimit të institucioneve të drejtësisë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Pasha!

A ka pyetje nga kolegët?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Pasha, që iu përgjigjet thirrjes dhe shprehët interesin për të qenë pjesë e këtij komisioni!

Kam dy pyetje. E para, lidhet me aktivitetin tuaj kërkimor-shkencor në kuadër të reformës në drejtësi, që është një kërkesë e ligjit, ku kandidati duhet të ketë kërkime dhe punime shkencore që lidhen me çështjet e reformës në drejtësi.

E dyta, sa ju, realisht dhe praktikisht, keni mundur të ndiqni ecurinë e reformës në drejtësi dhe a keni pasur mundësi të kontribuoni në përgjigje të thirrjes që ka bërë Kuvendi i Shqipërisë për angazhimin e të gjithë profesionistëve kudo që ata punojnë dhe jetojnë?

Faleminderit!

Suzana Pasha (Hoti) – Faleminderit!

Siç e tha edhe kryetari, ju të gjithë e keni CV-në time para dhe besoj se jeni njohur me të. E kam ndjekur hap pas hapi krijimin e institucioneve të drejtësisë, reformën në drejtësi, ndryshimet ligjore, vazhdimin e zbatimit të reformës dhe jam pjesë si çdo qytetar, si çdo jurist, si çdo qytetar apo deputet e kësaj reforme.

Gjithashtu, doja t'ju bëja me dije se kam qenë edhe një ndër anëtarët që kanë konkurruar për të gjitha pozicionet e komisionit të vetiungut dhe jam kualifikuar deri në fund, pra deri në momentin e votimit nga komisioni *ad hoc*, por fati nuk donte, prandaj mendoj se sot është një arsye tjetër.

Dua t'ju them edhe diçka se pavarësisht çfarë do të ndodhë nuk do të largohem kurrë nga profesioni im, por do të vazhdojë të punojë si avokate dhe juriste, sepse kjo është puna që di të bëj. Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Pasha!

Zoti Hyseni, ka pyetje.

Alket Hyseni – Kam një pyetje. Zonja Pasha, ju i keni përfunduar studimet për një periudhë 7-vjeçare. Kjo ka ardhur nga dashuria dhe pasioni për profesionin, sepse shoh që rezultatet nuk janë ato që ju krenoheni për profesionin?

Suzana Pasha Hoti – Faleminderit, për pyetjen!

Unë ndoshta nuk kam pasur mundësitë tuaja, sepse vij nga një familje jo e konsiderueshme si ju, pasi në moshën 10-vjeçare më ka vdekur babai (unë ju njoh thjesht nga mediet, sepse nuk ju kam as koleg dhe as shok), por di t'ju them se ia kam arritur dhe ia kam dalë në profesionin që kam zgjedhur dhe nuk do ta lë kurrë atë në sajë të punës sime.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ky komision është një komision *ad hoc*, i cili nuk do të jetë me kohë të plotë por të pjesshme...

Suzana Pasha Hoti – Unë prandaj jua thashë, zoti kryetar, e njoh shumë mirë punën në grup dhe di si ta koordinoj atë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Pasha!

A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Zonja Pasha, faleminderit për prezencën tuaj në komision dhe ditë të mbarë!

Suzana Pasha Hoti – Faleminderit dhe ju uroj punë të mbarë!

Ulsi Manja – Vazhdojmë me kandidaten e fundit në garë, zonja Lindita Rusmali.

Zonja Rusmali, mirë se erdhët në Komisionin e Ligjeve!

Jeni një nga kandidatet në garë për të qenë pjesë e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Në fakt, dosja juaj është e plotë dhe të gjithë kolegët e kanë mbi tavolinë. Natyrisht, edhe për ju vlen i njëjti rregull që brenda minutazhit që ne kemi përcaktuar për të gjithë kandidatët, do t'ju lutesha të shpalosnit përpara kolegëve të komisionit jo arsyet që ju shtyjnë, sepse arsyet mund të përmbliidhen me një fjalë, por diçka lidhur me njohuritë tuaja mbi reformën në drejtësi dhe zbatimin e kësaj reforme.

Fjala është për ju.

Lindita Rusmali – Faleminderit, zoti Manja!

Arsyet dhe njohjet janë bashkë. Unë jam këshilltare në Shërbimin e Monitorimit këtu në Kuvend dhe ajo që ne bëjmë për institucionet e pavarura është më shumë se ajo që pritet të bëhet për procesin e monitorimit të ngritjes së organeve të reja të drejtësisë.

Njohuritë për reformën janë njohuritë e çdo juristi që nuk mund të rrijë jashtë informacionit në lidhje me procesin, pasi edhe pjesa e të qenit këshilltar sigurisht më ka lënë më afër hapave në të cilat ka ecur reforma dhe momentit në të cilin jemi tani.

Ulsi Manja – A kanë pyetje kolegët?

Zoti Fino, a keni ndonjë gjë për të shtuar? Jo.

Me aq sa po shoh kolegët janë të bindur për njohuritë që ju keni për reformën në drejtësi dhe ligjet e kësaj reforme zonja Rusmali, prandaj meqë nuk ka pyetje ju uroj suksese dhe ditë të mbarë!

Lindita Rusmajli – Faleminderit!

Ulsi Manja – Zonja Rusmali ishte kandidatja e fundit nga të 9 kandidatët që ne i dëgjuam sot në këtë seancë dëgjimore dhe këtu përfundojmë pikën e katër të rendit të ditës.

Do të kemi një vlerësim të kriterëve ligjore dhe të performancës për secilin nga kandidatët pas kësaj dëgjese dhe në mbledhjet e ardhshme të komisionit do të ketë edhe një vendimmarrje për kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore, por edhe të performancës për të qenë pjesë e listës që do t'i paraqitet Kuvendit.

Këtu mbyllem mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Mbledhja e radhës do të jetë nesër dhe rendi i ditës do t'ju njoftohet nga sekretaria e komisionit.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

